



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____



_____ р./в.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 82-të të mbajtur më 14.02.2023 ka miratuar si në vijim.

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-1004/1, datë 11.02.2020, me pretendimin për vendimin e miratuar në mënyrë të kundërligjshme për dhënien e mbështetjes financiare për projekte investive. HIDHET POSHT KSHPK ka konstatuar se ka vepruar sipas pretendimeve me të njëjtat fakte si pretendimet në fjalë dhe ka marrë vendim brenda juridiksionit të saj.

Lënda numër 12-1004/1 datë 11.02.2020 të mbyllet dhe arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së të publikohet në formë të depersonalizuar në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Nga një parashtruesi i njohur, më datë 11.02.2020, një raport i është përcjellë -----
-- me pretendimet për një Vendim të miratuar në mënyrë të kundërligjshme për dhënien e mbështetjes financiare për projekte investive, sipas të cilit është konstatuar lënda numër 12-1004/1 e datës 02.11.2020. Në denoncim, parashtruesi thekson se vendimi i miratuar me të cilin jepet mbështetje financiare për ofertuesin dhe nënkryetarin e ----- kontestohet, se ka konflikt interesi dhe ndikimet korruptive në nxjerrjen e tij, është rezultat i ndikimeve të paligjshme dhe shpërdorimit të pozitës, duke shkaktuar shfrytëzim të papërshtatshëm dhe të paligjshëm të fondeve publike. Në të njëjtën kohë, parashtruesi vë në dyshim faktin se një kompani që është në falimentim mund të marrë ndihmë nga shteti për blerjen e aseteve të preکشme dhe kjo nuk ishte mundësi për kompanitë e tjera që u shfaqën si ofertuesit më të favorshëm në procedurën e falimentimit.

Gjatë kontrollit të kryer në procesverbalet e brendshme të Komisionit Shtetëror, u konstatua se Komisioni Shtetëror ka vepruar për një çështje të formuar pas ankesës me të njëjtin pretendim, të regjistruar në arkivin me numër 12-671/1. datë 30.01.2020, për të cilën është mbajtur seanca e 70-të më datë 09.06.2022, për të miratuar vendimin me numër 12-3970/8 datë 09.06.2022.

Pas shqyrtimit të lëndës në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se nuk ka elemente për veprim kompetent, sepse KSHPK-ja ka vepruar sipas pretendimeve me të njëjtin përshkrim faktik sikurse pretendimet në fjalë dhe ka marrë vendim brenda juridiksionit të saj.

Nga sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHKETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetar
Katica Nikolovska**

përgatiti: J.C
miratoi: K.N, anëtar i KSHPK-së

